
Zbulimi i një furre të vjetër në Kuç të Zi / *Un four antique dans Kuçi i Zi*

Damjan Komata

Citer ce document / Cite this document :

Komata Damjan. Zbulimi i një furre të vjetër në Kuç të Zi / *Un four antique dans Kuçi i Zi*. In: Iliria, vol. 1, 1971. pp. 263-268;

doi : <https://doi.org/10.3406/iliri.1971.1136>

https://www.persee.fr/doc/iliri_1727-2548_1971_num_1_1_1136

Fichier pdf généré le 19/03/2019

ZBULIMI I NJË FURRE TË VJETËR NË KUÇ TË ZI

Fshati Kuç i Zi gjëndet në anë të fushës së Korçës, 7 km. në juglindje të këtij qyteti, buzë rrugës automobilistike për në Bilisht. Gjatë punimeve bujqësore, në afërsi të këtij fshati (fig. 1) u ndeshën gjurmët e një muri me tulla dhe disa varre.




Fig. 1. Harta e zonës ku u zbulua furra

Punimet që u bënë këtu nga një ekspeditë¹⁾ e sektorit të Arkeologjisë të Institutit të Histori-Gjuhësisë u përqëndruan në dy pika: buzë rrugës automobilistike, ku u zbuluan varret, dhe në arën e quajtur Sopot, jo shumë larg banesave të fshatit, ku u ndeshën gjurmët e murit me tulla. Gërmimet treguan se këto të fundit i përkisnin një furre për pjekjen e qeramikës. Furra e zbuluar 0.30 m. nën sipërfaqen e tokës, kishte trajtën e një katerkëndëshi brinjët e të cilit përpu-

1) Ekspedita i zhvilloi punimet në muajin Tetor 1962. morën pjesë arkeologët S. Anamali, H. Spahiu, dhe autori.

theshin me katër pikat e horizontit; furra kishte këto përmasa: gjatësi 3 m. dhe gjerësi 2 m. Për nga mënyra e ndërtimit, ajo i përket tipit të furrave me dy të ndara²⁾ pjesa e sipërme (dhoma e pjekjes), ku vendosej materiali i përgatitur për pjekje dhe pjesa e poshtme (vatra), ku hidhej lënda djegëse.

Dhoma e pjekjes ndahet prej vatrës me një shtresë horizontale tullash, që formon skarën (fig. 2). Kjo e fundit mbështetet mbi katër çifte kolonash, (fig. 3 a) të lidhura ndërmjet tyre me harqe (fig. 3 b). Si kolonat edhe harqet përbëhen prej tullash, të cilat kanë formë katrore me përmasa 36-38 × 6-8 cm.




Fig. 2. Pamje e furrës nga sipër.

2) V.F. Gajdukeviç, *Antiçnije keramičeskije i obzhigatelnie peči*, M.L. 1934; A. Malm, *Gorni Moskovski gončarov XV-XVIII vjeka*, M.I.A. 12, M-L 1949, f. 50; I.A. Zhadova, *Prinos kem proçvaneto na keramičeskoto proizvodstvo v Preslav*, I.A.I. XII, Sofja, f. 232-234.




Fig. 3. Planimetri e prerje e furrës.

Trashësia e murit të çdo kolone përputhet me përmasat e tullës. Si material li-dhës ka shërbyer kudo balta. Në skarrën e furrës gjenden pesë rreshta vrimash, të formuara nga boshllëqet midis harqeve, të cilat shkojnë paralel me njera tjetrën në drejtim veri-jugë (fig. 2). Në gjendje më të mirë u gjetën të ruajtur vetëm dy rreshta, të cilët kanë nëntë vrima secili, kurse rreshtat e tjerë janë të dëmtuar. Vrimat nuk kanë trajta të rregullta, ato i ngjasojnë më tepër rrethit dhe katër-këndëshit. Përreth ato kanë qenë veshur me baltë, e cila, si pasojë e temperaturës së lartë, është ngurtësuar, kurse tullat e skarrës nën veprimin e po kësaj tempe-rature kanë pësuar plasje.

Vatra është e vendosur në tokë, dysHEMEJA e sËCILËS përbëhet nga baltë e pjekur. Në të dy anët e vatrës, nga lindja dhe perëndimi, gjenden dy gryka që kanë formë harkore me lartësi 60-80 cm. (fig. 3c). Këto, me sa duket, përdorshin për të ngarkuar furrën me lëndë djegëse, njëkohësisht edhe për pastrimin e saj nga hiri. Si lëndë djegëse është përdorur druri. Ndërtuesit e këtij objekti, duke pasur për qëllim që nxehtësia të mos delte jashtë vatrës i kanë veshur faqet e saj të jashtme me një shtresë balte dhe mbi të kanë hedhur argjil.

Se si ka qenë ndërtuar mbulesa e dhomës së pjekjes, nuk dihet me siguri, meqënëse nuk ruhen gjurmët e saj, prandaj në raste të tilla vlen të marrim para-sysh të dhënat analoge dhe për më tepër t'i drejtohem etnografisë. Në furra të kësaj natyre, mesa duket, ndërtohej një kube e përhershme prej tullash, me një ose dy gryka, nëpërmjet të cilave materiali i papjekur stivohej mbi skarrën e pjekjes. Në kohën e procesit të pjekjes së materialit, gryka mbyllej me pllakë,

3) M.K. Karger, *Drevnij Kiev*, vëll. I. 1958, f. 461.

e cila lyhej me baltë argjili³⁾. Sipas V. F. Gajdukjeviç⁴⁾, në shumicën e furrave të caktuara për pjekjen e tullave e tjegullave jo gjithmonë ndërtohej mbulesë e përhershme. Furra pa mbulesë të këtillë takohen edhe në kohën romake. Po kjo gjë praktikohet edhe sot në punishtet e zejtarisë për prodhime të këtij karakteri. Në këtë rast artikujt prej qeramike vendoseshin në dhomën e pjekjes dhe mbuloheshin nga sipër me copa enësh dhe tjegullash, midis të cilave lireshin boshllëqe jo të mëdha për daljen e tymit, pjesën tjetër e lyenin me brum argjilor. Mënyra se si bëhej pjekja e materialit është e qartë; gazet djegëse që formohehin në vatër, depërtonin nëpërmjet vrimave të skarrës në dhomën e pjekjes.

Ne u ndalëm këtu në mënyrën e ndërtimit të furrës dhe dhamë kryesisht detajet e saj për të krijuar një përfytyrim pak a shumë të plotë mbi furrën tonë dhe mënyrën e pjekjes së materialit në të.

Furra të këtilla për pjekjen e qeramikës e kanë origjinën që në kohën antike (periudha helenike)⁵⁾, përhapen në shkallë të gjerë në shekujt e mëvonshëm në provincat e perandorisë romake⁶⁾ dhe tradita e tyre vazhdon gjatë gjithë mesjetës⁷⁾. Nga pikëpamja konstruktive dhe funksionale ndryshimet që shohim në këto lloj objektesh gjatë këtyre periudhave nuk janë të mëdha. Në numrin e atyre të zbuluara deri tani përfshihen furra me përmasa të ndryshme dhe me dy lloj trajtash. Vihet re se ato që kanë trajtë kuadrati dhe përmasa relativisht të mëdha, zakonisht përdoren për prodhimin e materjalit të ndërtimit (tulla e tjegulla) dhe enëve të mëdha (si amfora dhe pitosa). Nga sa njohim, furra të këtij lloji janë gjetur në disa vende, si në bregun verior të Detit Zi, në territorin e Gjermanisë, në Rumani, Bullgari⁸⁾ etj. Kurse në furra me trajtë ovale ose të rrumbullaktë dhe përmasa më të vogla janë përdorur për pjekje prodhimesh të vogla si enë guzhine dhe objekte të tjera të vogla prej balte. Numri i tyre është më i madh dhe janë gjetur p.sh. të këtilla në Jugosllavi, Hungari, Rumani, Bashkimin Sovjetik etj. (9).

Furra e Kuçit të Zi, si objekti i parë i këtij lloji, të zbuluar në vendin tonë ka rëndësi, mbasi na jep të dhëna të reja mbi përpunimin e qeramijës së ndërtimit në këtë pellg. Se çfarë lloj artikujsh qeramike janë pjekur në furrën tonë, flasin vetë gjetjet e shumta të tullave e tjegullave brenda saj. Gjatë pastrimit të furrës përreth saj ose brenda nuk u gjetën objekte të tjera qeramike. Kjo dëshmon qartë se këtu kemi të bëjmë me një objekt që është përdorur për pjekjen e tullave dhe tjegullave, të cilat nevojiteshin si lëndë e parë ndërtimi. Duhet theksuar se si për kohën antike dhe gjatë mesjetës një degë të veçantë të zejtarisë e përbënte prodhimi i artikujve të materialit të ndërtimit, gjë që përputhet me nevojat e kohës. Edhe në territorin e vendit tonë tulla dhe tjegulla janë përdorur

4) V.F. Gajdukjeviç, *vep. e cit.* f. 40, 80-81.

5) *Dictionnaire des Antiquites Greques et Romaines*, vëll. XII, Paris 1896, f. 1255-1256, V.D. Bllavatskij, *Antiçnaja Arheologia Severnovo Priçernomorja*, Moskva 1961, f. 49.

6) R. Cagnat et V. Chapot, *Manuel d'argjeologie romaine II*, f. 462; S. Leoschske, *Die romischen Ziegelofen im Gemeindewald von Speicher*, Trierer Zeitschrift VI, 1931, fig. 2,3.

7) B.A. Ribakov, *Remesllo Drevnoj Rusij*, Moskva 1948, f. 344-352. A.L. Jakobson, *Srednjevekovij Hersones*, M.I.A., 17, Moskva 1950, f. 153.

8) V.D. Bllavatskij, *Vep. e cit.* f. 49-50 fig. 17. C. Blummer, *Technologie der Gewerbe und Künste*, vëll. II, f. 24. K. Schumaner, *Das romische Mainz Zeitschrift*, f. 1906, f. 28-29, Abh. 14. G. Stefan, *Un cuptor roman ce ars tigre descoperit la Carvan*, Studii si Cercetari de Istorie Veche 1-4, Bucuresti 1957, f. 341. Mitova Zdhonova, *Peshçi za keramika i keramidi ot Nove Archeologia*, 1, Sofja 1966, f. 38.

9) J. Todoroviç, *Fours paleoslaves a Visnjica*, Starinar, NS VII-VIII, Beograd, 1958, f. 329. R. Nansor, A. Naçs — *bendekepusztai arpadkori edényeketokemence*, Archaeologiai Ertesito vëll. 94, 1967, f. 20. M. Nicorescu, *Cuptoare de ars ceramica din secolele XIV-XV, de la Suseav*, Studii si Cercetari de Istoria Veche», 1, Bucuresti 1965, f. 109, fig. 5; B.A. Ribakov, *Vep. e cit.* f. 344.

gjerësisht në ngritjen e shtëpive të banimit e të ndërtesave të tjera me karakter shoqëror dhe në ndërtimet mbrojtëse, gjurmët dhe gërmadhat e të cilave gjenden me shumicë.

Gjithashtu duhet pasur parasysh se skarra horizontale përforcohej me harqe dhe kolona, për vetë faktin se mbi të vendosej një peshë e rëndë.

Furra pothuaj se analoge nga pikëpamja e ndërtimit e të trajtës së saj me ato të Kuçit të Zi janë furra e zbuluar në fshatin Madara (10), në afërsi të Preslavit (Bullgari) dhe ajo e Kievit (11). Këto kanë trajta katrore dhe kanë shërbyer për pjekjen e tullave (datohen me shekujt IX-X të e. sonë). Objektit tonë i she mbëllen edhe një furrë e zbuluar në Jugosllavi (12) në shtresat romake.

Është e vështirë të jepet një mendim i prerë për kohën se kur ka qenë ndërtuar dhe përdorur furra e Kuçit të Zi. Gjatë gjurmimit si të furrës ashtu edhe të terrenit rrethues, nuk u gjet material datues me përjashtim të disa stolive prej bronxi (13) që dhanë varret e zbuluara aty pranë dhe që i përkasin kulturës së shekujve X-XI e. sonë.

Në lidhje me problemin e datimit ne mund të gjykojmë me tepër nga vetë materiali i përdorur në ndërtimin e këtij objekti. Për të vendosur një datim në këtë rast mund të nisemi nga trajta e përmasat e tullës së vetë objektit, të cilat na drejtojnë në shekujt para pushtimit romak. Një mbështetje të mirë për këtë gjejmë në materialin masiv, të përdorur në ndërtimet e Apollonisë së Ilirisë, ku tulla me përmasa të ngjashme (38 × 38 × 8 cm) datohen në shekujt IV-I para erës sonë.

Si përfundim mund të themi me bindje të plotë se objekti i sipërshkruar ka shërbyer për prodhimin e qeramikës masive për ndërtim, kurse përsa i përket kohës së ngritjes së tij, në bazë të materialit qeramik të zbuluar aty, duke aluduar me materialin e Apollonisë mund të vendosim në shekujt e fundit para pushtimit romak.

10) Madara, Raskopki i prouçuanija II, Sofia 1936, f. 25-26.

11) M.K. Karger, *Vep. e cit.* f. 458.

12) R. Maric, *Iskopavana na Orascu* Starinar, NS, II, 1951, f. 122-123, fig. 26.

13) Materiali është i pabotuar, ruhet në fondet e Muzeut Arkeologjik.

14) A. Mano, *Të dhëna mbi qeramikën masive të Apollonisë të përdorur si materla ndërtimi* S.H. 1965, 1, f. 55-75.

UN FOUR ANTIQUE DANS KUÇI ZI

La mise au jour d'un four dans le village de Kuçi zi (district de Korçe) a été faite par l'expédition du secteur d'archéologie de l'Institut d'Histoire et de Linguistique.

Le four a une forme rectangulaire, dont les angles se rapportaient aux quatre coins de l'horizon. Ses dimensions sont 3,0 × 2,0 m. Il appartient au type de four à deux divisions: la partie supérieure (l'aire de cuisson) et la partie inférieure (le foyer). Ces deux parties sont divisées par une couche horizontale de briques qui forme une grille. La grille du four était formée par cinq rangées de trous par lesquels la température était distribuée dans l'aire supérieure où était mis à cuire le matériel céramique.

De tels fours à cuire les objets de céramique tirent leur origine depuis les temps antiques. Ils sont amplement répandus dans les siècles suivants dans les provinces de l'Empire Romain et leurs traditions ont continué aussi durant le moyen âge.

Le four de Kyçi Zi, comme le premier objet de ce genre mis au jour dans notre pays, a son importance du fait qu'il atteste de la façon la plus évidente de l'existence d'une production locale du matériel céramique de construction. Les trouvailles indiquent que dans ce four étaient cuites des briques et des tuiles, articles rentrant amplement dans le bâtiment.

Pour ce qui est de l'époque de ce four, on peut le dater, sur la base du matériel massif de céramique qu'on y a mis au jour, dans les derniers siècles avant la domination romaine.